

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË



NR. 777 Akti  
Dt. 16.07.2019

Nr. 1416 Vendimi  
Dt. 30.07.2019

**VENDIM**

**Per regjistrimin si person juridik ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë e përbërë nga:

**GJYQTAR : MARIANA SHEGANI ( DEDI )**

me cilësinë e gjyqtarit të vetëm, sot më date 30.07.2019, mori në shqyrtim kërkesën qe i perket :

- KËRKUES:** Qendra “Faktoje”, organizatë jofitimprurëse me seli në Tiranë, në adresën Rr. Nasi Pavllo, Pallati “Edil-al”, Shkalla 1, Kati 3, Ap 8, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive Klodiana Kapo, e cila me anë të prokurës së posacme nr. 3448 rep./1512 kol. datë 10.07.2019 ka autorizuar Av. Krenar Loloci dhe Av. Vera Batalli, vec e vec dhe bashkarisht, për të kryer veprimet përkatëse në lidhje me regjistrimin e qendrës përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- OBJEKTI:** Regjistrimi i Qendrës “Faktoje” në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 39 e vijues të Kodit Civil, Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, si dhe Ligji nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse

Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë, Gjykata, pasi analizoi dokumentacionin në tërësi,

## VËREN

Në bazë të Aktit të Themelimit të rezulton se themeluesit Erion Tase, Llazar Semini, Brunilda Bakshevani, Elizabeth Gowing, Dorian Matlija dhe Albana Kasapi, të gjithë në cilësinë e personave fizikë, kanë vendosur të krijojnë Qendrën "Faktoje".

Qendra themelohet si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi, e cila ka për qëllim zhvillimin e gazetarisë investigative dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme për të rinjtë në kuadër të kauzave sociale, ekonomike dhe kulturore.

Sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit qëllimet e Qendrës konsistojnë në:

Verifikimin e vërtetësisë së deklaratave dhe pretendimeve të bëra në të gjitha nivelet e jetës publike ;

Faktimin e mbajtjes së premtimeve të qeverisjes lokale dhe qëndrore, përmes artikujve, aktiviteteve dhe studimeve të ndryshme ;

Zhvillimin e gazetarisë investigative, përmes aktiviteteve, artikujve, trajnimeve, mbi çështje të ndryshme politike, ekonomike, kulturore dhe sociale;

Nxitjen e debatit publik, mbi reformat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të orientuara drejt Integritimit Europian.

Zhvillimin e qëndrimit kritik dhe të edukojë të rinjtë, përmes forumeve dhe debateve publike, mbi fakte dhe analiza konkrete.

Zhvillimin e intervistave, fokus grupeve dhe studime e analiza që ndihmojnë në analizimin e premtimeve publike mbi çështje të ndryshme publike.

Dhënie e ndihmës në zhvillimin e gazetarëve të rinj dhe bashkëpunimin me Departamentin e Gazetarisë dhe Televizionin Publik, duke ndihmuar në edukimin, por edhe në ndryshimin e sjelljeve për kauza të ndryshme.

Zhvillimin e edukimit mediatic të të rinjve, përmes aktiviteteve për ta në bashkëpunim me median, duke patur në qendër kauzat sociale, ekonomike, kulturore.

Qendra krijohet për një kohë të pacaktuar. Selia e Qendrës ndodhet në: Adresën: Rr.Nasi Pavllo, Pallati "Edil-al", Shkalla 1, kati 3, Ap 8, Tiranë.

Organet drejtuese të Qendrës janë: Bordi i Drejtorëve, si organi më i lartë vendim-marrës i Qendrës, i përbërë nga 6 (gjashtë) anëtarë dhe Drejtori Ekzekutiv.

Anëtarët e parë të Bordit të Drejtorëve, të përcaktuar në Akt Themelimi dhe Statut janë Erion Tase, Llazar Semini, Brunilda Bakshevani, Elizabeth Gowing, Dorian Matlija dhe Albana Kasapi.

Drejtori i Parë Ekzekutiv i përcaktuar në Akt Themelimi dhe në Statutin e Qendrës është Znj. Klodiana Kapo, lindur më 16.04.1981, me banim në Rrugën Him Kolli, P. 33, Ap. 31, Tiranë.

Burime të tjera financimi dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj të dhëna pa kushtëzime që bien ndesh me kushtet e statutit, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, nëpërmjet kërkesës për regjistrimin e personit juridik, nënshkruar nga Av. Krenar Loloci, i autorizuar me prokurë të posacme nr. 3448 rep./1512 kol. datë 10.07.2019, nga ana e Drejtores Ekzekutive të Qendrës, kërkohet regjistrimi i Qendrës "Faktoje" në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me këto dokumenta për depozitim në regjistrer:



Akt Themelimi i Qendrës "Faktoje", nr. 3446 rep./ nr. 1511 kol., datë 10.07.2019;

- Statut i Qendrës "Faktoje", nr. 3447 rep., datë 10.07.2019;
- Kërkesë për për regjistrimin e personit juridik nr. 3448 rep./ 1512 kol., datë 10.07.2019, shoqëruar me aktin e përfaqësimit prokurë e posacme nr. 3448 rep./1512 kol. datë 10.07.2019;
- Dokument Identifikimi (letërnjoftim elektronik) i përfaqësuese ligjore Znj. Klodiana Kapo;
- Dokument bankar për pagesën e burimeve të financimit.

Nga analiza e mësipërme, rezulton se kërkesa është e drejtë, dhe si e tillë duhet pranuar.

### PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te Ligjit Nr.8788 datë 07.05.2001 " Për organizatat jofitimprurëse",  
Ligjit Nr.8789 datë 07.05.2001 " Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"

### VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik te Qendrës "Faktoje" në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me objekt te veprimtarise :

Verifikimin e vërtetësisë së deklaratave dhe pretendimeve të bëra në të gjitha nivelet e jetës publike ;

Faktimin e mbajtjes së premtimeve të qeverisjes lokale dhe qendrore, përmes artikujve, aktiviteteve dhe studimeve të ndryshme ;

Zhvillimin e gazetarisë investigative, përmes aktiviteteve, artikujve, trajnimeve, mbi çështje të ndryshme politike, ekonomike, kulturore dhe sociale;

Nxitjen e debatit publik, mbi reformat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të orientuara drejt Integritimit European.

Zhvillimin e qëndrimit kritik dhe të edukojë të rinjtë, përmes forumeve dhe debateve publike, mbi fakte dhe analiza konkrete.

Zhvillimin e intervistave, fokus grupeve dhe studime e analiza që ndihmojnë në analizimin e premtimeve publike mbi çështje të ndryshme publike.

Dhënien e ndihmës në zhvillimin e gazetarëve të rinj dhe bashkepunimin me Departamentin e Gazetarisë dhe Televizionin Publik, duke ndihmuar në edukimin, por edhe në ndryshimin e sjelljeve për kauza të ndryshme.

Zhvillimin e edukimit mediatik të të rinjve, përmes aktiviteteve për ta në bashkëpunim me median, duke patur në qendër kauzat sociale, ekonomike, kulturore.

Qendra krijohet për një kohë të pacaktuar.

Selia e Qendrës ndodhet në: Adresën: Rr.Nasi Pavllo, Pallati "Edil-al", Shkalla 1, kati 3, Ap 8, Tiranë.

Organet drejtuese të Qendrës janë: Bordi i Drejtorëve, si organi më i lartë vendim-marrës i Qendrës, i përbërë nga 6 (gjashtë) anëtarë dhe Drejtori Ekzekutiv.

Anëtarët e parë të Bordit të Drejtorëve, të përcaktuar në Akt Themelimi dhe Statut janë Erion Tase, Llazar Semini, Brunilda Bakshevani, Elizabeth Gowing, Dorian Matlija dhe Albana Kasapi.

Drejtori i Parë Ekzekutiv i përcaktuar në Akt Themelimi dhe në Statutin e Qendrës është Znj. Klodiana Kapo, lindur më 16.04.1981, me banim në Rrugën Him Kolli, P. 33, Ap. 31, Tiranë.

Burime të tjera financimi dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj të dhëna pa kushtëzime që bien ndesh me kushtet e statutit, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Të bëhen shënimet përkatëse në Regjistrin Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe të depozitohen aktet shoqëruese.

Tiranë, më datë 30. 07.2019.

**GJYQTARE**  
**MARJANA SHEGANI (DEDI)**

